



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 8.3.2022, ora 11: 00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Sorina Koti, Blerina Gjylameti, Enslemvera Zake, Arbi Agalliu, Emilja Koliqi, Edmond Spaho, Benet Beci, Erion Braçe, Anila Denaj, Bujar Leskaj, Alban Xhelili, Vullnet Sinaj, Pranvera Resulaj, Etjen Xhafaj.

Mungojnë:

Alfred Rushaj, Jorida Tabaku, Antoneta Dhima, Shpresa Marnoj, Dashamir Shehi, Agron Shehaj.

Të ftuar:

Edona Bilali – Ministër Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Ana Petani – Specialiste për startup-et dhe inovacionin

Vangelt Duni – Ekspert ligjor pranë Kryeministrisë

Migena Muslli – Këshilltare e ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Elira Demiraj – Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Arjana Dyrmishi – Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit Ekonomik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Mirëmëngjes, të nderuar kolegë deputetë!

Sikundër kemi njoftuar, më në fund sot kemi diskutimin final mbi ligjin “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”. Pas një kalvari të gjatë diskutimesh nëpër labirintet e burokracisë së administratës, apo jo, Anila? Në fakt, ky ligj është një histori më vete. Megjithatë, lajmi i mirë është se jemi në finale të ligjit, dhe tashmë besoj se do të hapet një kapitull i ri për të gjithë ata sipërmarrës të rinj, që janë në këtë industri.

Sigurisht, pas debateve të shumta, kemi arritur jo çdo gjë që kemi dashur, kjo edhe për shkak edhe të disa opinionëve të disa ministrive, në lidhje me të cilat nuk e kam fshehur as rezervat e mia e as faktin se nuk kam qenë dakord, sepse kam menduar se është një komunitet që kërkon një trajtim shumë të veçantë, për shkak të natyrës. Kam pasur fatin të komunikoj dhe të vazhdoj të komunikoj me shumë nga sipërmarrësit e rinj. Është një surprizë interesante edhe prezenca në këtë komision e përfaqësuesve të një sektori, siç ishte ai i *Fintech*-ut, të cilët na provuan se në përballje me administratën publike janë shumë hapa më përpara, për hir të së vërtetës. Është një komunitet, të cilin do të duhet ta mbështesim. Qeveria shqiptare ka akorduar një fond të deklaruar prej rreth 10 milionë eurosh për katër vitet e ardhshme. Megjithatë, nuk janë vetëm fondet, por janë edhe iniciativat. Nëse ju kujtohet, në takimin e fundit në këtë komision, bashkë me titullarët e një agjencie të rëndësishme, asaj kundër pastrimit të parave, ne patëm një grup prej këtyre djemve e vajzave shumë të talentuara, që na kërkuan disa ndryshime ligjore, të cilat ne vijojmë t’i mbështesim.

Ju kemi informuar edhe në lidhje me një plan mbështetës, si dhe kërkesat e tyre për të ndërmjetësuar pranë institucioneve të rëndësishme, që fillojnë nga Banka e Shqipërisë e deri te AKSH-i. Pra, është një komunitet, në lidhje me të cilin do t’i lutesha të gjithë anëtarëve të nderuar të komisionit, që ta kemi në vëmendje dhe ta konsiderojmë si prioritet. Siç thashë, sot është një ditë shumë e gëzuar për ne, e gëzuar patjetër edhe për Ministrinë e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, për shkak se do të kalojmë ligjin.

Në radhë të parë, para se të filloj mbledhjen, do të doja t’u uroja grave të komisionit, ministres, përfaqësueseve të ministrive: Gëzuar Festën! Ardhhtë sa më e mbarë për ju!

Është një kohë e bukur, që ditën e kësaj feste të kalojmë edhe ligjin e *startup*-eve.

Kuorumi është verifikuar dhe jemi në rregull.

Media mund të futet brenda.

Të ftuar për këtë çështje, kemi ministren e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, zonjën Bilali; zonjën Petani, specialiste për Startup-et dhe Inovacionin; zotin Vangelt Duni, ekspert ligjor pranë Kryeministrisë; zonjën Migena Muslli, këshilltare e ministrit. Mirëserdhe në komision, Migena!

Kemi edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përfaqësuar nga zonja Arjana Dyrmishi dhe Elira Demiraj.

Mirëserdhët në komision! Kënaqësi që ju shoh! Me Elirën kemi punuar gjatë. Urime për detyrën e re shumë të rëndësishme! Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit apo jo? Urime dhe mbarësi!

Relatore kemi zonjën Enslemvera Zake. Eni Zake do t'ju thërras gjithë kohës, për lehtësi. Zonja Zake është marrë veçanërisht me ligjin.

Prezantimi i ligjit është bërë. Nëse ministrja apo përfaqësuesit e ministrisë kanë diçka për të shtuar, veç atyre që kanë thënë herën tjetër, janë më se të mirëpritur. Nëse jo, fjalën do ta ketë relatorja.

Edona Bilali – Shkurtimisht, vetëm për t'ju falënderuar të dyja palëve, në lidhje me rrugëtimin që patëm dhe finalizimin me sukses të këtij ligji, i cili ndihmon jo pak të rinj. Sidomos duke pasur parasysh edhe situatën në të cilën ndodhet sot rinia dhe Shqipëria, me atë që po ndodh brenda e jashtë, krijohet një stimul ekonomik dhe një mundësi jo e vogël nëpërmjet këtij ligji, i cili është vetëm hapi i parë drejt mundësisë së mbështetjes jo vetëm të startup-eve, por të të gjithë ekosistemit. Kësisoj, faleminderit!

Eduard Shalsi – Atëherë, zonja Zake, fjala për ju!

Enslemvera Zake – Falemnderit!

Dua t'u uroj të gjitha zonjat: Gëzuar festën e 8 Marsit!

Fillimisht, do të doja të përgëzoja ministrinë, veçanërisht ministren, në lidhje me finalizimin me sukses të këtij projektligji. Në cilësinë e komisionit përgjegjës, ne e kemi shqyrtuar dhe e kemi analizuar projektligjin në çdo pikë të neneve të tij, duke u konsultuar edhe me aktorët që preken nga ky projektligj, njëkohësisht edhe për të kuptuar më mirë se si funksionojnë startup-et, por edhe për t'u thelluar në implementimin e këtij projektligji.

Ky projektligj "Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve" është propozuar nga Këshilli i Ministrave dhe është hartuar nga grupi i punës, i kryesuar nga Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe me asistencën teknike të GIZ-it.

Siç e thashë, Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton projektligjin në cilësinë e komisionit përgjegjës, bazuar në nenet 32 e 38 të Rregullores së Kuvendit, si dhe në përputhje me nenin 81, pika 1 dhe 83, pika 1 e Kushtetutës.

Qëllimi i këtij projektligji është krijimi i një kuadri rregullator e institucional të favorshëm për krijimin dhe zhvillimin e startup-eve dhe mbështetjen e ekosistemit të tyre për nxitjen e kërkimit, realizimin dhe përdorimin e ideve inovative, si dhe modeleve, produkteve e proceseve të reja, të cilat sjellin risi në çdo fushë për zhvillimin ekonomik. Objektivi kryesor i këtij projektligji është përcaktimi i rregullave bazë, procedurave si dhe organet shtetërore kompetente për vetëdeklarim, mbështetjen, zhvillimin dhe monitorimin e startup-eve.

Projektligji synon që përmes mbështetjes për zhvillimin e startup-eve, të mundësojë gjithashtu edhe lehtësimi i krijimit, i hyrjes në treg dhe ushtrimi i veprimtarisë së startup-eve, krijimin e një klime të favorshme për tërheqjen, përfshirjen dhe mbajtjen e talentit e të burimeve njerëzore brenda vendit, lehtësimin dhe mbështetjen në aksesimin e burimeve financiare, si dhe përfshirjen sociale dhe diversitetin në mbrojtje të vlerave demokratike.

Objektivat kryesorë të projektligjit na janë prezantuar edhe nga ministrja, në dëgjuesën që kemi bërë më herët në këtë projektligj, ndaj nuk po ndalem. Kryesore është mbështetja e startup-eve në fazën fillestare të biznesit, në mbështetjen e ekosistemit, për krijimin e një klime të favorshme për to, organet shtetërore që ngarkohen, detyrat dhe kompetencat që kanë për mbështetjen e startup-eve, si dhe përcaktimi i kriterëve, rregullave, përgjegjësi në lidhje me certifikimin, mbështetjen, vlerësimin dhe monitorimin e startup-eve.

Projektligji ka parashikuar edhe organet përgjegjëse për realizimin e objektivave, që është ministri përgjegjës për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Këshilli i Startup-eve, Komisioni i Vlerësimit, si dhe ministritë apo institucionet e tjera publike, të cilat impaktohen nga ndikimi në këtë projektligj.

Ky projektligj ka evidentuar në mënyrë të qartë dhe konkrete detyrat e ministrit përgjegjës për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, zhvillimin e politikave shtetërore në fushën e mbështetjes së startup-eve, koordinimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të startup-eve. Më pas ministri përgjegjës i propozon Këshillit të Ministrave miratimin e fondeve buxhetore për grantet dhe format e tjera të mbështetjes së startup-eve, lehtësuesve dhe palëve të treta, që ishte një risi e futur si pjesë e këtij projektligji, miraton modelet tip të marrëveshjes dhe bashkëpunimit, të nënshkruar nëpërmjet ministrisë, startup-eve, lehtësuesve dhe palëve të treta, miraton e publikon thirrjet e granteve të tyre. Më pas, nga një këshill apo komision,

këto vlerësohen dhe shpallen projektet fituese, që pastaj i drejtohen Këshillit të Ministrave për alokimin e granteve sipas projekteve apo startup-eve fituese.

Projektligji parashikon ngritjen e një komisioni të Këshillit të Startup-eve dhe regjistrimi i startup-eve bëhet përmes një vetëdeklarimi në regjistrin elektronik të startup-eve dhe lehtësuesve, duke u paraqitur me një pasaportë startup-i apo dhe me pasaportën e lehtësuesve.

Një risi tjetër e këtij projektligji është edhe ofrimi i shërbimeve të startup-eve *one stop shop*, i cili konsiston në dhënien e informacionit mbi kuadrin ligjor rregullator në fuqi, dhënien e këshillimit, regjistrimin në regjistrin tregtar, mbrojtjen e pronësisë intelektuale për periudhën e inkubimit, organizimin e aktiviteteve informuese e njohëse nëpërmjet startup-eve të interesuara, si dhe dhënien e shërbimeve të tjera në drejtim të lehtësimit të aktivitetit tregtar të startup-eve.

Përzgjedhja e startup-eve, siç e thashë, bëhet nëpërmjet këtij komisioni, ndërsa më pas, Komisioni i Vlerësimit i propozon fituesit ministrit përgjegjës për Sipërmarrjen. Më pas, ky i fundit i propozon Këshillit të Ministrave projektvendimin për miratimin e granteve të alokuara. Arsyeya pse është ndërmarrë kjo iniciativë për një projektligj të ri, është sepse, referuar edhe raportit të vlerësimit të ndikimit RIA, aktualisht në Shqipëri nuk ka një mekanizëm nxitës apo kuadër ligjor, i cili do ta rregullonte specifikisht këtë lloj biznesi. Sektori i Sipërmarrjes së Startup-eve dhe programeve mbështetëse të tyre ka pasur probleme lidhur me hyrjen në treg e me përthithjen e investimeve të huaja, pavarësisht interesit në rritje që kanë pasur të rinjtë.

Legjislacioni aktual ekzistues për ndërmarrjet e vogla e të mesme, rregullon edhe disa çështje që nuk lidhen direkt me startup-et, por indirekt, si fondet e zbatuara nga AIDA. Pra, ky kuadër ligjor nuk është i adresuar specifikisht për startup-et, prandaj lindi nevoja e krijimit të një projektligji të ri. Sa i takon impaktit pozitiv dhe eksperiencën globale, këto i kemi dëgjuar nga ministrja, ndaj nuk po ndalem. Aktualisht ne, disa anëtarë të komisionit kemi bërë konsultime me aktorët e biznesit, me universitetet, por edhe me startup-e, që aktualisht operojnë në treg. Ky projektligj nuk synon përafrimin me ndonjë akt të BE-së. Dy fjalë për efektet financiare, e më pas po ndalem pak te saktësimet, ndryshimet.

Projektligji mbart kosto financiare për buxhetin e shtetit, pasi parashikon ngritjen e regjistrimit dhe të portalit elektronik për startup-et, sipas RIA-s, duke përlllogaritur shumë që do të alokohet nga buxheti i shtetit në formën e granteve dhe shërbimeve mbështetëse, lidhur me trajnimin dhe këshillimin, vlerësohet që efekti të jetë në shumë 1 miliard e 208 mijë lekë ose 10 milionë euro, shumë e cila mendohet të bëhet e disbursueshme për katër vitet në vijim.

Për secilin nga këto vite janë parashikuar gjithsej rreth 302, 1 milionë lekë, ku përfshihen grantet në formën e mbështetjes financiare direkte për startup-et që plotësojnë kriteret, si dhe pagesën për anëtarët e komisionit të përbërë nga pesë anëtarë *ad hoc* për përzgjedhjen e ideve fituese. Lidhur me evidentimin e disa problematikave që kemi pasur në projektligj, e kemi bërë në konsensus me ministrinë përgjegjëse, pavarësisht të gjitha elementeve tejet pozitive, që ka pasur dhe ka sjellë miratimi i këtij projektligji. Do të doja të ndalesha pak te disa elementë të diskutueshëm të projektligjit, të cilët diktojnë nevojën për ndërhyrje. Së pari, në si deputetë, përveç gjërave që theksova, kemi ndërmarrë një sërë takimesh konsultuese, së bashku me kryetarin e komisionit, me aktorë të ndryshëm në fushën e inovacionit e teknologjisë, siç janë bizneset që operojnë aktualisht në tregun e startup-eve, me lehtësuesit e inkubatorëve, aceloratorë me ekspertë të ekonomisë, por edhe me universitetet. Pas këtij procesi konsultimi, që na ka shërbyer për të njohur më mirë edhe funksionimin e startup-eve, lind nevoja për saktësim e përmirësim të qëllimit dhe objektit të këtij projektligji, specifikisht saktësimi në përkufizimet e projektligjit, duke filluar që nga vetë përkufizimi i konceptit të startup-eve. Këto ndërhyrje janë të rëndësishme për shkak të përkufizimit, që përcakton konceptet bazë, të cilat më pas gjejnë trajtim në këtë projektligj, pasi janë përmendur disa herë në nenet përkatëse të këtij projektligji. Në këtë kuadër janë bërë saktësime dhe riformulime në përkufizimin e konceptit të vetë startup-it, është shtuar në gamën e lehtësuesve një kategori tejet e rëndësishme e tyre, e cila mungonte, siç është subjekti që ofrojnë në startup-et financiare, alternative, si investimet kapitale, investimet kapitale të riskut, skema e *voucher*-it ose për inovacionin, *business angels*, por dhe është përmirësuar përkufizimi nomad dixhital, kjo në konsultim me këshilltaren e Komisionit të Ekonomisë, por edhe me këshilltarët e ministrit përgjegjës, të cilët suportojnë dhe janë hartuesit e këtij ligji.

Saktësimet kanë qenë të nevojshme edhe në evidentimin apo përcaktimin e fushës së përgjegjësisë, funksionet dhe detyrat e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, kjo për vetë faktin se kompetencat apo strukturat e Ministrit të Shtetit janë disi të kufizuara, sepse nuk është një ministri më vete e linjës. Në këtë kontekst, është shmangur përplasja e kompetencave dhe e fushës së diskrecionit mes ministrive të ndryshme, të cilat janë përgjegjëse në lidhje me planifikimin dhe menaxhimin e fondeve buxhetore, në kuadër të ligjit “Për menaxhimin financiar dhe buxhetor”.

Saktësime në projektligj janë bërë edhe lidhur me përcaktimin e subjekteve përfituese për mbështetjen me grante, duke përfshirë tashmë në këtë kategori jo vetëm startup-et apo lehtësuesit, të cilët janë një pjesë shumë e rëndësishme e këtij procesi. Është saktësuar gjithashtu edhe lloji i shërbimeve që do t’u ofrohen këtyre subjekteve përmes

shërbimit Startup One Stop Shop. Gjithashtu, është vlerësuar si i nevojshëm edhe saktësimi i monitorimit të masave mbështetëse dhe i kufizimeve në maksimum të skemave të abuzimit me grantet e përfituar. Për këtë qëllim është shtuar nga ne përcaktimi: “Në rast të konstatimit të rasteve të abuzimit nga ana e mbështetësve të startup-eve, lehtësuesit apo palët e treta, atëherë ministri përgjegjës për sipërmarrjen mund t’i propozojë Këshillit të Ministrave kthimin e shumës së përfituar sipas këtij ligji”.

Po ashtu, projektligji ka pasur nevojë edhe për përmirësime të shumta të teknikës legislative, në mënyrë që të jetë sa më i thjeshtë, sa më i kuptueshëm dhe sa më i zbatueshëm, sepse ky është qëllimi i ligjit, pasi disa terma që ishin referuese krijojnë vështirësi në aplikim e në zbatim.

Kaq, zoti kryetar! Në qoftë se do të ndalemi në analizën nen për nen, mund t’ju propozojmë si ishte apo si bëhet, ose të referoj vetëm ndryshimet, në mënyrë që të mos zgjatemi shumë në leximin e ndryshimeve të çdo neni.

Eduard Shalsi – Besoj se janë rakorduar edhe me ministrinë dhe me përfaqësuesit, apo jo?

Enslemvera Zake – Po.

Eduard Shalsi – Janë rakorduar?

Edona Bilali – Kemi vetëm dy gjëra të shkurtra për të propozuar, për të shtuar sot tek neni 3, pika ‘c’, “Lehtësuesit e startup-eve”. Këtu listojmë se cilët janë të gjithë aktorët e tjerë të ekosistemit, përveç startup-eve në vetvete. Gjithashtu, propozojmë që të shtojmë arsimin parauniversitar dhe shkollat profesionale. Në variantin e mëparshëm ishin vetëm institucionet e arsimit të lartë, por me ritmin që jemi duke parë në teknologji mendojmë se duhet të nisë që në arsimin parauniversitar edhe shkolla profesionale. Ndërkohë, kemi edhe një gjë të vogël, që më shumë është teknike: në nenin 16, pika 1, tek aktet nënligjore, duhet shtuar edhe neni 5. Pra, vetëm këto dy teknikalitete.

Falemnderit!

Eduard Shalsi – Jemi në rregull me këto. Dakord?

A janë të reflektuara këto tek ato që do të lexoj unë? Jo. Në rregull!

Atëherë, zonja Zake, do t’i mbash shënim të dyja, kur të kalojmë në miratimin nen për nen të ligjit.

Nga ana e kolegëve, a ka ndokush pyetje, koment, sugjerim apo vërejtje për të bërë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëro? Ishe duke komunikuar në celular, zoti Sinaj dhe ndoshta s’e kishit mendjen kur e ezauruam komunikimin.

Nëse s'ka diçka nga ana e kolegëve, kalojmë në miratimin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Keni diçka për të thënë? Në rregull! Patjetër, zoti Sinaj.

Ndizeni pak mikrofonin, ju lutem!

Vullnet Sinaj – Një nga pyetjet që kam unë, është në lidhje me periudhën e inkubimit: kur fillon periudha e inkubimit për një startup?

Pyetje tjetër: te raporti i vlerësimit të ndikimit janë parashikuar disa objektiva: shpërndarja e të paktën 80 % të shumës së dedikuar për startup-et brenda katër viteve; rritje në 80 % të numrit të startup-eve të regjistruara, brenda vitit 2025; garantimi i mbijetesës së të paktën 50 % të startup-eve të reja, të cilat përfitojnë nga kjo politikë pas fazës së inkubimit; rritje me 40 % e kapitalit të huaj për mbështetjen e startup-eve brenda vitit 2025. Kësisoj, pyetja ime është: ku i keni mbështetur këto objektiva, që vendosni 80 %, 80 %, 50 %, 40 %? A keni ndonjë ide se sa startup-e mund të kemi, që keni nxjerrë këto objektiva te raporti i vlerësimit të ndikimit?

Pyetja tjetër që kam, është: si do të tërhiqen fondet e huaja?

A po i shënoni? Sepse janë disa pyetje.

Si do të tërhiqen fondet e huaja? Cilët do të jenë donatorët për këto fonde, në lidhje me startup-et në Shqipëri?

Pyetje tjetër: a ka vende të tjera të rajonit e të Europës, që kanë një ligj për startup-et dhe pse parashikoni se do të kemi nomadë, se do të kemi persona të huaj, të cilët do të aplikojnë në skemën tonë të startup-eve, kur ata mund të kenë ligj në vendet e tyre?

Kam edhe një pyetje: sa do të jetë kostoja për përgatitjen e regjistrimit dhe të portalit elektronik për startup-et?

Edhe unë do të doja të na jepnit një shembull të një startup-i të suksesshëm në Europë ose në rajon.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Zonja Gjylameti e ka kërkuar fjalën.

Blerina Gjylameti – Unë e kërkoja fjalën për procedurë, sepse, realisht, do të duhet që sot ne të vijojmë me pjesën e votimit nen për nen. Ne kemi kaluar dy seanca për *start-up*-et, të parën kur u bë prezantimi i projektligjit, të dytën kur kemi pasur pyetje-përgjigje.

Kështu që t'i rikthehem edhe një herë fazës së pyetje-përgjigjeve, i bie pastaj që, ose të mos kemi pasur kohën e duhur, ose më pas ta shtyjmë votimin, se nuk mund të vazhdojmë që edhe të votojmë nen për nen, edhe të vazhdojmë me pyetje-përgjigje.

Eduard Shalsi – Zonja Gjylameti, një sqarim, të lutem!

Nuk kemi bërë dy seanca. Kjo është seanca e dytë. Kemi bërë vetëm një seancë që ka qenë prezantimi i ministres, ka pasur disa pyetje dhe kjo është seanca e dytë.

Në seancën e dytë gjithkush nga deputetët ka të drejtën të vijoje, edhe sikur të ishin më shumë se dy seanca, tre, katër apo pesë, dhe në momentin që e gjykon se ka për të bërë pyetje, ka për të bërë komente, është i lejuar t'i bëjë.

Zonja Resulaj.

Pranvera Resulaj – Faleminderit!

Nuk kisha pyetje, në fakt. E përgëzoj ministren për prezantimin dhe për nxitjen e këtij ligji, gjithashtu, grupin e punës që ka përshtatur të gjithë teknikën legjislativë!

Unë, thjesht, iu referova faktit të rëndësisë që ka nxitja e bizneseve të reja, aq më tepër me përshtatshmërinë dhe zhvillimet e vrullshme teknologjike do të sugjeroja për universitetet (ju e thatë që janë pjesë e lehtësuesve, aty shtuat edhe arsimin profesional dhe bëtë shumë mirë) që të mos mjaftohen thjesht me aplikimin apo përfitimin e granteve, por mendoj se është momenti që të krijojnë ato qendrat e tyre teknologjike të inkubacionit, sepse, në të njëjtën kohë, kemi edhe studentë, të cilët në një moment të dytë mund të bëhen edhe aplikuesit kryesorë dhe përfituesit e granteve për *start-up*-et. Kjo vlen sidomos për universitetet të cilat kanë në rajonet e tyre zhvillime ekonomike me një dinamikë shumë të madhe dhe kjo do t'i ndihmojë.

Pra, mendoj se qendrat teknologjike të inkubacionit janë të nevojshme për t'u ndërtuar dhe për t'u themeluar nga universitetet, për t'u dhënë një mundësi më të mirë studentëve dhe të gjithë të rinjve që duan të aplikojnë për idetë e tyre në fushën e biznesit dhe të inovacionit.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Zoti Leskaj dhe më pas zoti Xhelili.

Bujar Leskaj – Meqenëse kryetari na krijoi mundësinë të bëjmë edhe ndonjë propozim shtesë, duke falënderuar kryetarin tonë të komisionit...

Eduard Shalsi – Më fal, nuk thashë “propozim shtesë”, por thashë pyetje, komente, ndërkohë mund ta mbaj shënim...

Bujar Leskaj – Edhe po të mos ma jepnit lejen, kryetar, unë do ta bëja propozimin tim, por unë e thashë për kortezi, për t'u sjellë mirë me ju.

Eduard Shalsi – Keni të drejtën që, nëse palët bien dakord, ta propozojmë, në qoftë se do kohë për t'u menduar.

Bujar Leskaj – Nuk besoj se do të dojë kohë.

Unë mendoj se keni bërë shumë mirë te neni 13, pika 3, pra mbështetja e *start-up*-eve nëpërmjet ekosistemit, duke pasur parasysh edhe grupin kryesor që ne, në rast se do të jemi të ndershëm dhe të sigurtë duhet ta përkrahim përmes këtij projektligji, kur të kthehet në ligj, që keni vendosur të pika “ç” “Fuqizimi i grave sipërmarrëse”, por duhet të keni edhe një pikë të veçantë për fuqizimin dhe mbështetjen e të rinjve të diplomuar në universitetet brenda vendit ose jashtë vendit, jo për faktin se është e re ministrja, por për të gjitha politikat në kuadër të rrjedhjes së madhe që kemi. Një theks i veçantë te mbështetja e të rinjve mendoj se do të ishte një vlerë e shtuar në këtë ligj.

Fondi që është disponibël për *start-up*-et, unë mendoj se është fond modest dhe ka nevojë për transparencë, përgjegjshmëri, për thellim dhe për llogaridhënie gjatë përdorimit të tij.

Megjithëse jam me shumë vonesë, nëse do të kem kohë, do të përgatis ndonjë propozim, por mendoj se duhet të jetë një nen i veçantë për sa i përket transparencës në përdorimin e këtij fondi. Pra, *start-up*-et janë edhe ide të reja, janë edhe implementime të reja. Qeveria në shumë raste vuan pak për sa i përket transparencës dhe këtu duhej të ishte në mënyrë më të veçantë.

Kam një pyetje, dhe përgjigjja që ju do të jepni, është shumë e rëndësishme për mua për të kuptuar qëllimet tuaja, përveç atyre çfarë keni shkruar.

Si e konsideroni ju, si ministre, *start-up*-in e famshëm të menusë së 100 fshatrave turistike? Përkrahja, që ju do të bëni, do të ketë shumë raste të tilla? Si do t'i trajtoni ju këto raste?

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Zoti Xhelili.

Alban Xhelili – Faleminderit, zoti kryetar!

Së pari, dua ta përgëzoj shumë sinqerisht këtë nismë, sepse e vlerësoj shumë, për sa i përket ndihmës që do t'u jepet *start-up*-eve ose marrjes në konsideratë të *start-up*-eve.

Kam dy pyetje. Duke qenë se mendoj se s' duhet të kalojmë në nivelet e atyre ligjeve, që ne miratojmë, por personat e interesuar i marrin vesh të fundit, unë doja të dija se sa është fondi, ose a keni ndonjë parashikim lidhur me fondin që do të përdorni për informimin e *start-up*-eve, të personave të interesuar, të subjekteve të interesuara për të përfituar nga lehtësitë?

E dyta, është parashikuar fondi 10 milionë, i ndarë në 4 vjet. Ligji hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Duke qenë se jemi në fillim të vitit, parashikohet që ligji të hyjë në fuqi në vitin 2022.

A është parashikuar në buxhetin e vitit 2022 fondi që do t'i takojë këtij viti lidhur me *start-up-et*?

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Fjala për ministren për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve.

Edona Bilali – Pyetja e parë ishte periudha e inkubimit. Periudha e inkubimit zgjat 24 muaj dhe fillon në momentin e vetëdeklarimit në regjistrin e-Albania. Pra, në momentin që plotësohet ky regjistër, i cili kërkon më pak se 1 minutë për t'u plotësuar, automatikisht printohet një dokument që është pasaporta e *start-up-it* dhe aty ka validitetin. Pra, në qoftë se sot është data 8 mars 2022, dokumenti do të shkruaj “i vlefshëm deri më 8 mars 2024”, është dygjuhësh. Kjo për sa i përket periudhës së inkubimit.

Lidhur me përthithjen e fondeve të huaja, ne kemi parashikuar që, përveç fondeve të buxhetit të shtetit, në dispozicion për *start-up-et* dhe ekosistemin do të jenë edhe fondet e huaja. Kjo është një eksperiencë tashmë e krijuar, pavarësisht se ka ndodhur vitet e fundit. Mund të përmendim këtu programin e BE-së “*EU for inovation*”, i cili ka qenë, gjithashtu, bashkudhëtar edhe për krijimin e ligjit dhe për të gjithë procesin e konsultimit publik.

Duke kaluar te pyetja për formulat që kanë vendet e tjera të rajonit, a kanë ato legjislacion përkatës dhe si i mbështesin *start-up-et*? Theksoj se kjo analizë në formën e një *desc reserch* është bërë që në hapat e parë dhe janë studiuar, sigurisht, jo vetëm vendet e rajonit, por edhe vendet e BE-së.

Ajo çfarë ne synojmë me këtë ligj, është të sjellim një formulë, e cila të jetë më konkurruese se sa vendet e rajonit. Nga rajoni sot për sot Serbia është më përpara edhe në shpërndarjen e fondeve, edhe në *success rate*, pra sa për qind e këtyre *start-up-eve* arrijnë të mbijetojnë dhe të shkojnë edhe jashtë kufijve.

Prandaj, ne kemi ofruar në ligji, dhe synojmë edhe në aktet nënligjore, por edhe në thirrjet që do të hapen për grante, një formulë, e cila do të jetë më incentivuese, në mënyrë të tillë që ne, si Shqipëri, të bëhemi faktor më shpejt. Madje, ligji dhe formula e përfitimit të grantit janë edhe më ambicioze se sa të disa vendeve që tashmë janë anëtare të BE-së.

Lidhur me nomadët digjitalë, theksoj se modeli më i mirë sot për sot është ai i Estonisë. Megjithatë, pavarësisht dëshirës dhe ambicies për të qenë në atë nivel, kemi parë edhe modele të tjera, të cilat do të mund të ishin më të përshtatshme për një vend si Shqipëria për të thithur të rinj, por jo vetëm të rinj, të fushave të ndryshme, pra jo vetëm nga *start-up-et*, profesionistë të lirë, pedagogë që janë duke punuar në distancë për shkak të kushteve të pandemisë e kështu me radhë.

Ky nen është futur në ligj, sepse është edhe në harmoni me atë çfarë miratoi Ministria e Brendshme në muajin dhjetor për lëvizjen e lirë dhe konceptin e nomadit digjital. Ajo çfarë ne mendojmë se do të shtojë vlerë, është fillimisht duke u ofruar një postacion falas në një hapësirë të përbashkët pune për një periudhë të caktuar, sepse mendojmë se çdo i ri, që po kërkon të krijojë një *start-up*, vjen në Shqipëri dhe ndërvepron me palët e treta, shpenzon para, gjithashtu, për të jetuar, për t'u ushqyer, për t'u argëtuar.

Lidhur me kostot e dy regjistrave që do të jenë pranë *e-Albania*, ne këtë javë kemi nisur diskutimin teknik me AKSHI-n, sepse ishte e rëndësishme që të kishim versionin final dhe vizionin se çfarë do të jenë edhe aktet nënligjore dhe si do të jetë ndërfaqja e regjistrat, prandaj nuk e kam një vlerë sot, por janë dy regjistra. Ky është kontributi deri tani.

Duke vijuar me sugjerimin e zonjës Pranvera, theksoj se është parashikuar që në momentin që do të hapim thirrjet, ato do të jenë të veçanta për kategori të ndryshme lehtësuesish. Pra, për universitetet do të ofrohen të tjera mundësi, krahasuar me hapësirat e bashkëpunimit apo me akseleratorët e me radhë; dhe këtë e mbajtëm shënim për ta shtuar te thirrja.

Lidhur me sugjerimet e zotit Leskaj, theksoj se të rinjtë janë kryefjalë e këtij ligji. Ndoshta do të kishte qenë mirë për t'i specifikuar në veçanti, por, duke marrë eksperiencën rajonale, europiane, globale, të gjitha *start-up*-et, është ndonjë përjashtim shumë i rrallë kur *start-up*-et janë të krijuara dhe të zhvilluara jo nga të rinjtë.

Për sa i përket transparencës, ne kemi futur dy nene më lart, te neni 14, pika 1, fundi i fjalisë është: “*Start-up*-et dhe lehtësuesit e *start-up*-ve të vetëdeklaruar në regjistër mund të përfitojnë mbështetje financiare me fonde buxhetore në formën e granteve, si dhe nga burime të tjera financimi, përfshirë, por pa u kufizuar në donatorët e huaj, edhe investime nga lehtësuesit, sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi, nëse plotësojnë kriteret dhe rezultojnë fitues pas një procesi konkurrues dhe transparent përzgjedhjeje”.

Këtë fjali kemi menduar ta fusim në ligj, ndërkohë që në aktet nënligjore do të përcaktohet qartësisht cila është forma e arritjes deri te granti. Ajo çfarë ne kemi pritshmëri nga ky ligj, nga aktet nënligjore, por edhe nga vetë skuadra e ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes është që të krijojmë një fond, i cili disbursohet në mënyrën më transparente të mundshme.

Këtë e arrijmë nëpërmjet filozofisë që ka jo vetëm ministri i Shtetit, por e gjithë qeveria për kalimin në *paperless*, *contactless* dhe çdo gjë të bëhet *online*, prandaj edhe regjistri është *online*, prandaj edhe aplikimi do të jenë *online*, si dhe përgjigjet do të jenë *online*. Pra, kjo bëhet për të shmangur çdo kontakt fizik midis palëve.

Sugjerimi i zotit Xhelili lidhur me informimin është shumë i drejtë dhe e vlerësoj, gjithashtu, këtë koment, sepse, pavarësisht se në kryeqytet flitet shumë për sipërmarrjen, për *start-up*-et, po të largohemi pak nga kryeqyteti, jo shumë kilometra, se nuk po flas për zonat e thella, informacioni është shumë herë më i mangët. Shumë fonde kombëtare janë të përthithshme nga Vermoshi në Konispol, por, po të shohim hartën e shpërndarjes gjeografike të këtyre fondeve, nuk reflektohet, se kemi gjithmonë zona afër qendrave urbane, të cilat përthithin më shumë, prandaj janë vënë (po, ky është parashikim, se nuk është futur në ligj) 8 akte nënligjore.

Ne kemi futur të lehtësuesit organizuesit e eventeve dhe organizuesit e eventeve në konceptin e ligjit dhe të *start-up*-ve janë pikërisht kompani apo agjenci, të cilat merren me promovimin e *start-up*-ve, por kjo në një kontekst të lidhur drejtpërdrejt me përfituesit (do të jetë e sqaruar në VKM). Marr rastin, nuk mundet dikush të shkojë në Shkodër dhe të shpërndajë fletëpalosje, por do të jetë e targetuar në qendrat e inkubimit që ka qyteti, në universitet, në arsimin parauniversitar, pra aty ku mund të jetë i aksesueshëm ky ligj.

Gjithashtu, “*EU for innovation*”, që është partneri ynë, dhe do të vazhdojë të jetë edhe në vijim, gjithashtu, merr aktivitete, të cilat lidhen me promovimin, pra një pjesë e mbulojmë ne, një pjesë do të mbulojnë edhe ata.

Lidhur me pyetjen e fundit për 2,5 milionë euro për vitin 2022, kjo është sfida, prandaj për ne ishte, veçanërisht shumë e rëndësishme, ishte që ligji, i pari, por edhe aktet nënligjore në vijim me operativitetin e sistemit për të aplikuar për këto grante të jetë gati sa më shpejt, në mënyrë të tillë që ne të fillojmë e të disbursojmë fonde, të cilat janë parashikuar edhe për vitin 2022.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Zoti Sinaj.

Vullnet Sinaj – Ky është vërtet një projektligj shumë i rëndësishëm që u jep mundësinë vërtet atyre që kanë ide për të bërë biznes, sidomos atyre që kanë ide brilante për të bërë biznes, prandaj edhe unë po këmbëngul pak.

Me sa kam kuptuar unë nga projektligji, faza e parë fillon me regjistrimin e biznesit në regjistrin e ministrisë apo në portalin që do të hapni. Pas regjistrimit, ju si ministre bëni thirrje për konkurrin, sipas temave që ju keni përcaktuar që ndihmojnë ekonominë tonë. Pas kësaj bëhet konkurrimi dhe pas konkurrimit del fituesi, i cili përfiton grantin. Pas fituesit që përfiton grantin, kemi fazën e inkubimit dhe pas inkubimit ai regjistrohet në regjistrin tregtar.

Tani unë ngul këmbë tek inkubimi. Pse duhet të fillojë inkubimi në momentin e regjistrimit dhe mos të fillojë inkubimi në momentin kur ai ka dalë fitues? Me “inkubim” unë

kuptoj që ne po i krijojmë mundësitë një biznesi të ri, po e ngrohim, po e mbajmë ngrohtë, që ai të shpërthejë, të ketë sukses. Atëherë, nuk kemi pse ia vendosim 24-mujorin. Në qoftë se kemi menduar që një biznes të konsolidohet do, të paktën, 2 vjet, që ideja të qartësohet dhe të ecë përpara, pastaj ai të ketë mundësi të paguajë taksa, të mbajë punonjësit, të mos e mendojmë këtë fazën e inkubimit nga momenti i regjistrimit, por ta fillojmë këtë fazën e inkubimit nga momenti që ai fiton grantin. Nga ky moment ai vërtet ka në dorë resurse financiare për të zhvilluar aktivitetin e vet.

Aplikoj unë i pari dhe 24-mujori më fillon nga dita e sotme. Aplikon Albani pas një muaji dhe këtij i fillon 24-mujori pas ditës së aplikimit. Në fakt, pas momentit që shpallet fituesi dhe merr grantin, ka kuptim inkubimi. Kjo është arsyeja pse unë ju bëra pyetjen se kur fillonte inkubimi.

Faleminderit!

Edona Bilali – Ndoshta nuk e sqarova saktë, por nuk është kjo kronologjia që do të ndjekim.

Po e marr me shembull konkret: unë jam një *start-up*. Hyj në portalin e-Albania dhe vetëdeklarohem si *start-up*, sot më 8 mars. Me 8 mars mua më fillon periudha e inkubimit, por kjo periudhë inkubimi mua më ndihmon për të më bërë fillimisht të përzgjedhshëm për fonde, por edhe për të më dhënë lehtësira të tjera, siç është rasti i *one-stop-shop*-it, pra sepse unë mund të dua të bëj një biznes, por fillimisht nuk di se çfarë efektesh financiare ka regjistrimi i subjekti; nuk di juridikisht se cili është vendimi më i mirë, në qoftë se unë dua të hyj me një ortak; a duhet ta hap si person fizik apo si sh.p.k e kështu me radhë. Aksesin për grante e kanë që ditën e parë, ashtu si edhe ditën e fundit të 24-mujorit, të periudhës së inkubimit, mjafton që ato të kenë ndjekur ose të jenë duke ndjekur program inkubimi dhe fondet mund t'i marrin në çdo moment. Periudha e inkubimit nuk është e lidhur vetëm me grantimin, por është e lidhur me periudhën, në të cilën ato janë nën një mbështetje apo nën një aureolë mbrojtjeje nga ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes që ato mos të gabojnë, se nuk është vetëm ideja për të marrë fonde, por synimi është që ata të vazhdojnë të jenë operativë në treg. Prandaj ne kemi futur *one-stop-shop*-in, ku kryesorja do të jetë fushë ekonomike-juridike, por do të ketë edhe lehtësi. Për shembull, në qoftë se kanë një patentë, do të mundën të marrin informacion nëpërmjet nesh, sigurisht, nga institucionet që e japin këtë ekspertizë. Inkubimi nuk është i lidhur drejtpërdrejt me grantimin, më tepër është i lidhur me periudhën, në të cilën ne kemi brenda sistemit, brenda mbrojtjes së Ministrisë të Shtetit për Sipërmarrjes.

Eduard Shalsi – Pra, jo nuk është e lidhur vetëm, por nuk është fare i lidhur, zoti Sinaj, periudha e inkubimit me periudhën e seleksionimit të fituesve. Startup-et aplikuese dhe ato fituese për pasojë mund të jenë në numër shumë më të kufizuar sesa startup-et që janë duke gjalluar në këtë moment apo edhe në momentin e regjistrimit. Periudha e inkubimit është një periudhë, pavarësisht aplikimeve, që ka të bëjë me faktin e ngjizjes dhe fazës fillestare të biznesit, pra po i jepet mundësia të vetëregjistrohet, të vetëdeklarohet. Dikush mund të aplikojë dhe të shpallet fitues. Për dijeninë tënde, praktikrat botërore tregojnë se 94, 95 dhe 96 për qind e startup-ve për këto trende janë të destinuara për të dështuar.

Vullnet Sinaj – Thirrja juaj si ministre për konkurrim bëhet përpara regjistrimit, apo pas regjistrimit të këtyre bizneseve?

Edona Bilali – Në momentin që do të hapet thirrja, një nga kushtet është që ato duhet të jenë pjesë e regjistrimit. Ato mund ta bëjnë edhe ditën që hapet thirrja, pra, nëse thirrja do të hapet më 1 maj, ai shkon në e-Albania bën këtë vetëdeklarimin, që i kushton 1 minutë, dhe menjëherë aplikon për thirrjen.

Eduard Shalsi – Mos e ngatërro me thirrjet e granteve të blegtorisë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vullnet Sinaj – Nuk e ngatërroj as thirrjen e granteve të blegtorisë. Dua të qartësoj ndonjë paqartësi, sepse, nga çfarë kam lexuar, del sikur do të ketë një konkurrim për çdo thirrje, pra jo çdo startup, që regjistrohet, ka të drejtën të përfitojë grantin, do të ketë një konkurrim, apo jo? Ju thatë që çdo *start-up*, që është i regjistruar, ka të drejtën të përfitojë grant nga fillimi deri në fund.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të aplikojë. E kam gjithmonë për të mirën e atyre bizneseve që do të lindin nga këto startup-e. Fazën e inkubimit nuk mund ta kenë nga momenti që regjistrohen, por nga momenti që janë fituese.

Eduard Shalsi – Edhe një herë, zoti Sinaj, nuk ka asnjë argument që të mbështesë faktin që një startup-i, pas periudhës të shpallurit fitues, duhet t'i numërohet koha e inkubimit. Koha e inkubimit nuk ka lidhje me faktin e të aplikuarit apo të qenit fitues. Periudha e inkubimit ka të bëjë me kohën që një biznesi të saponjizur i duhet për t'u rritur apo për të dështuar. Periudha e inkubimit në vetvete përmban disa lehtësira, nuk trajtohet si një biznes, pas dy vjetëve që është rritur.

Përmendët punën e transparencës, ministria ka qenë shumë e vëmendshme dhe e kujdesshme. Nuk mundet që e gjithë gjëja të përmblihet në ligj. Ligji jep kuadrin e përgjithshëm, ndërkohë që ministria, pastaj ju do të keni mundësi të monitoroni edhe VKM-të

që dalin, sepse ky ligj është i paaplikueshëm pa VKM-të, do të përcaktojë edhe mënyrën sesi do të aplikohet ligji. Nuk kemi një VKM, por kemi disa VKM që, në dijeninë time, ministria i ka filluar tashmë përgatitjet.

Është vërtet një proces që ndodh për herë të parë në Shqipëri. Si çdo proces që ndodh për herë të parë, ka edhe shqetësime, ka edhe pikëpyetje. Nuk e thashë me humor, zoti Sinaj, historinë e aplikantëve në fushën e blegtorisë, sepse mbaj mend se sa debate të mëdha kemi bërë me teorinë e famshme “*first in, first out,*” ndërkohë që shpresoj të jetë rregulluar sistemi, që u bllokua ditën e parë.

Zoti Leskaj, e përmbyll me pyetjet, komentet, sepse do të kalojmë te votimi nën për nën, ku do të doja të ndërhyjë relatorja me shpjegime të sakta.

Bujar Leskaj – Sugjerimet tona janë tejet dashamirëse, zoti kryetar, për shkak se ky është një ligj modern në dobi të sipërmarrjes, por dua ta theksoj që ju, qeveria, nuk duhet ta kompromentojë implementimin e këtij ligji. Pavarësisht si ju dalin rezultatet, votat që merrni, ju keni probleme si qeveri, si maxhorancë me transparencën, me llogaridhënien dhe ky ishte qëllim i atyre propozimeve, sugjerimeve modeste dhe miqësore që bëra.

Ministrja më thotë: “Ky ligj ka kryefjalë rininë”. Po, shumë mirë, kjo dihet se të rinjtë janë dhe më inovativë, por janë të pakta fjalitë, ku kryefjala dhe kallëzuesi nuk vendosen, për më tepër kur ke një ligj me 17 nene. Ju duhet të vendosni në një moment (të gjeni një nën ose në fillim kur keni dhënë përkufizimet, ose aty ku ju sugjerova, ku me të drejtë theksoni gratë) të theksoni drejtpërdrejtë të rinjtë universitarë të diplomuar brenda dhe jashtë vendit. Kjo do të jetë një shtysë akoma më tepër dhe në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për rininë.

E dyta, unë fola për transparencë dhe ju folët për transparencë përzgjedhëse. Shumë mirë që shmangen kontaktet nëpërmjet internetit, aplikimet nëpërmjet portalit përkatës e të tjera, por e kisha fjalën për transparencën në implementim, transparencën e përfundimit të projektit. Ju, ndoshta, këtë mund ta vendosni te rregulloret. Meqenëse nuk kemi kohë këtu në komision, nëse do ta përgatisnim në mënyrë individuale, do ta përcjell propozimin edhe në seancë, por ju duhet të mos e kompromentoni ligjin, duhet të kërkoni transparencën në përfundim në implementim. Pyetja që bëra për *strat-up-in*, ishte një shaka miqësore, pavarësisht në themi shaka, në atë projekt është një korrupsion i madh, e ka bërë një institucion i qeverisë suaj, e ka implementuar drejtpërdrejt një drejtues institucioni. Ndaj Fondit Shqiptar të Zhvillimit deri tani nuk po shikojmë asnjë masë administrative si fillim, megjithatë është puna juaj.

Kam edhe diçka të fundit, është shumë miqësore, shoqërore për ministren. Përgjithësisht brenda 6 muajve nxirren aktet nënligjore; ju u shprehët në një moment që edhe implementimi këtij ligji që vitin e parë është sfidë, është sfidë për qeverinë, por, në radhë të parë, është sfidë për ju, personalisht. Në rast se doni ta përmbushni me sukses këtë sfidë, afatin në fund, te neni 16 nuk do ta kërkonte 6 muaj, por 3 muaj. Vetëm kështu ju, si ministre, do të keni mundësi të jeni e suksesshme në implementimin e këtij ligji. Unë nuk jua di aftësitë. Uroj të jeni e aftë dhe e suksesshme, personalisht ju, por, me çfarë lexova këtu, e keni të ngarkuar ligjin, janë 4-5 VKM që kanë procedurën e tyre, brenda 6 muajve; t'i do të kalosh në muajin shtator, që është viti i parë i qeverisë dhe do të jesh me zero ligje të implementuara.

Pastaj, në rast se do të vazhdosh me ato praktikatat e këqija të buxhetit që në muajin dhjetor do t'i kaloni të gjitha projektet, miratimin, implementimin e të tjera, do të krijoni një traditë të keqe. Ju duhet ta konsultoni me drejtuesit tuaj, por sfida juaj si ministre, si ministri, është që brenda 3 muajve të dalin aktet nënligjore, pastaj fillon implementimi juaj; se ju për regjistrin keni thënë 6 muaj, janë aplikimet e tjera, pra nuk do të keni kohë ta implementoni atë ligj.

M'u kujtua, zoti kryetar, Merkeli, e cila pozicionin e parë në qeverinë e Kohlit e ka pasur si ministre për Rininë dhe për Gruan dhe, kur ka përcjellë projektligjin e parë pas 3 muajve, ata ministrat konservatorë që nuk e donin, e bllokuan dhe në fillim ka qarë, se nuk e kaloi dot ligjin. Ti shumë mirë që e kalon ligjin, por mos qash tek implementimi. Bëni mirë ta sfidoni veten te ky afat 3-mujor.

Eduard Shalsi – Jam i bindur që ministrja do ta propozonte një muaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ke pyetje, se më the komente?

Zoti Leskaj, të lutem!

Një nga gjërat që duhet të ndryshojmë në punën tonë, të paktën po mbajmë një kalendar shumë strikt monitorimesh nga momenti i aplikimit të ligjit e deri tekl ai i VKM-ve, ka të bëjë pikërisht me këtë fakt: nuk është bërë më parë, nuk është kërkuar llogari, nuk janë monitoruar aktet nënligjore në funksion të ligjit. Jo më larg sesa para disa ditëve kishim rastin e një ligji të kaluar me shumë shpejtësi dhe sot që flasim, në muajin e tetë, pra ishim në një trysni të jashtëzakonshme nga ministria, nuk kemi VKM-në për shkak se nuk bien dakord.

Dua të them që, në lidhje me transparencën, ligji nuk mund të përmbajë më shumë nga ç'është. Nga ana tjetër komisioni jo vetëm për këtë ligj, por për të gjitha ligjet që po kalojnë në komision, mban një kalendar në lidhje me VKM-të dhe informohemi sapo del

VKM-ja, në mënyrë që, nëse ka pyetje, nëse ka komente, nëse ka sugjerime, të vijojmë t'i bëjmë, por një nga pikat kyçe, besoj unë, të suksesit të punës sonë është të vendosim një rend monitorues, kontrollues në lidhje me aktet nënligjore që dalin në zbatim të ligjit apo se si po implementohet ligji. Nuk është një praktikë e zakonshme për parlamentin që 3 muaj pasi të miratohet ligji, 6 muaj pasi të miratohet ligji apo 9 muaj, ministrat të raportojnë në lidhje me ecurinë e ligjit. Dakord? Do të jemi brenda kohës për të përcaktuar, siç kemi përcaktuar me ligjet që kemi kaluar në komision, edhe për këtë ligj një kalendar informacioni apo edhe raportimi.

Ka disa kolegë, në dijeninë time, të paktën në 3 raste jam informuar, që kanë çuar sugjerime, pasi është miratuar ligji, edhe në lidhje me VKM-të. Edhe kjo është një praktikë e pazakontë. Edhe këtë nuk e kanë bërë shumë deputetë. Pra, shqetësimet që i kanë ngritur në komision, i kanë materializuar edhe nëpërmjet kërkesave formale ose joformale, kjo nuk ka shumë rëndësi, por ka deputetë që kanë trokitur për të kërkuar aktet nënligjore për të sugjeruar apo për të komentuar.

Zoti Sinaj, të lutem, se jemi në limitet e fundit, shumë shkurt që të kalojmë te ligji.

Vullnet Sinaj – E nderuar Ministre, të uroj shumë suksese!

Këtu duket sikur ka një problem po të bëj shumë pyetje, por është fati juaj që jeni ministre, por edhe i keq që jeni për herë të parë dhe më keni hyrë në fushën time të biznesit, prandaj do të më mirëkuptosh në pyetjet që do të bëj: a keni vendosur një objektiv sa fitues, sa startup-e do të kemi pas 2 vjetësh që do të dalin nga inkubimi? Kryetari më tha që e kam mendjen te subvencionet; 10 mijë fermerë do të fitonin nga këta 10 milionë euro. Me këta 10 milionë euro, sa startup-e do të lindin pas 2 vjetëve? Pra, a keni një objektiv, një sfidë tuajën të brendshme që pas 2 vjetëve me këta 10 milionë euro do të keni kaq startup-e që do të hyjnë në ekonominë shqiptare?

Eduard Shalsi – Zonja Ministre, t'ia lehtësoj pak zotit Sinaj, se hyri te fusha e biznesit, a do të më lejoni pak?

Zoti Sinaj, ky është një komunitet, i cili ka përafërsisht rreth 150-200 aktorë, pra ato që i quajmë startupista. Ka edhe një numër shumë më të limituar lehtësuesish, ku hyjnë inkubatorët e biznesit, akseleratorët e biznesit, janë disa universitete. Madje do të ishte me interes për zotin Sinaj dhe për anëtarët e tjerë të komisionit të marrim edhe dy raportet e fundit të “*EU for inovacion*”, është një program, i cili ka financuar, në mos gaboj, rreth 6 milionë euro për inovacionin në Shqipëri. Unë kam një raport, raportin e dytë dhe të tretin nuk i kam, por mund t'i vë në dispozicion për t'u familjarizuar me aktorët e këtij tregu. Një aktor tjetër i rëndësishëm i tregut janë edhe universitetet qofshin shtetërore, qofshin private.

E vështirë të parashikohet me saktësi se sa do të jetë numri. Ajo që është synuar me këtë paketë mbështetëse, është që një komunitet shumë interesant, me ide inovative, kreative, pasionante, të mbështetet edhe duke ditur se jo të gjitha idetë, madje shumica e ideve janë të destinuara për të dështuar, por, zoti Sinaj, është një eksperiencë e re. Shumë vende kanë kaluar para shumë vjetësh nëpër një rrugëtim të tillë, vështirë të bëhet një parashikim i saktë, por, sikurse ju thashë, numrat janë këto, shifrat janë këto dhe në muajt në vijim do të shikojmë interesin e atyre që aplikojnë, por e rëndësishme nuk është thjesht se cilët janë ata që do të fitojnë, e rëndësishme është që do të inkurajohen të gjithë ata që, në një mënyrë apo një tjetër, nuk kanë pasur mundësi të financojnë edhe kostot fillestare të ideve të tyre dhe që t'i ngjizin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mirë, atëherë faleminderit, të gjithë kolegëve për diskutimet! Kalojmë në votimin nen për nen të ligjit.

Unë do të citoj nenet. Zonja Zake, ju lutem, më ndiqni, por me shumë shpejtësi!

Në parim e kemi miratuar ligjin.

Neni 1. Kush është dakord me propozimet e komisionit?

Zonja Zake, më thotë këshilltari i komisionit që e keni prezantuar. Unë mendoj se e kemi miratuar në parim ligjin. Nuk e kemi miratuar. E miratojmë ligjin në parim. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1.

Të lutem, cito vetëm ndryshimet!

(Enslemvera Zake flet pa mikrofon.)

Eduard Shalsi – Atëherë, kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Të lutem, ndize mikrofonin!

Enslemvera Zake – Riformulohet me këtë përmbajtje: “Ky ligj përcakton rregullat bazë, procedurat, si dhe organet shtetërore kompetente për vetëdeklarimin, mbështetjen, zhvillimin dhe monitorimin e startup-ve dhe të okosistemit mbështetës të tyre në Republikën e Shqipërisë”.

Eduard Shalsi – Kush është dakord me neni 2, me reformulimet e komisionit? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3.

Enslemvera Zake – Në nenin 3 të projektligjit bëhen këto ndryshime: “Përpara çdo përkufizimi sugjerohet vendosja e fjalëve “është”, “janë” “nënkupton”, në varësi të kontekstit të fjalisë”.

Në germën “a” termi “ekosistem” zëvendësohet me termin “ekosistem mbështetës për startup-et”

Në germën “c” shtohet propozimi i ministres, pas fjalëve “institucionet e arsimit të lartë” shtohen “arsimi parauniversitar dhe shkollat profesionale”. Në fund të fjalisë shtohen fjalët: “Si dhe subjektet që u ofrojnë startup-ve financime alternative, si: investim kapital, investim kapital risku, skema *voucher* për inovacionin, engjëjt e biznesit”.

Germa “ç” riformulohet me këtë përmbajtje, duke pasur në konsideratë edhe rekomandimet e Komisionit të Ligjeve: “Nomadë digjitalë janë shtetasit e huaj që punojnë në vende të ndryshme, jo në një zyrë apo seli të regjistruar dhe punojnë kryesisht në distancë ose në lëvizje, të cilët përfitojnë statusin e përfitimit të punonjësit lëvizës digjital, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për të huajt”.

Germa “d” riformulohet me këtë përmbajtje: “Startup-e janë individët dhe personat fizikë ose juridikë të regjistruar në regjistrin tregtar të Republikës së Shqipërisë, të cilët, referuar objektit të aktivitetit të tyre, janë konceptuar, janë krijuar dhe veprojnë, me qëllim nisjen e realizimit dhe zhvillimit të një modeli biznesi, produkti dhe shërbimi inovativ dhe/ose teknologjik e të veçantë me potencial rritjeje të shpejtë, të zbatueshëm në praktikë për përmirësimin e ndjeshëm të modeleve të biznesit, produkteve dhe shërbimeve ekzistuese”.

Eduard Shalsi – Kush është dakord me ndryshimet e propozuara? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Një sqarim të vogël, zoti Sinaj “nomadët digjitalë”, Kroacia dhe Maqedonia e Veriut kanë përgatitur një ligj të veçantë. Ka vende që e kanë përfshirë brenda një ligji, jo domosdoshmërisht nomadët digjitalë janë startup-e, janë persona, të cilët me një kompjuter mund të punojnë nga larg, në një vend, i cili u ofron kushte lehtësuese. “Nomadët digjitalë” si koncept në këtë ligj do të duhet të shoqërohen me një VKM që të përcaktojë edhe staturën e tyre, por janë individë, të cilët udhëtojnë nga një vend në vendin tjetër, mund të punojnë...

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Urdhëro?

Për çfarë të aplikoni?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nomadët digjitalë nuk janë të lidhur me startup-et, po të them, mund të krijojnë një ide, mund të aplikojnë një ide. Nomadët digjitalë, siç e definojnë edhe termi “nomad”, janë njerëz që lëvizin nga një vend, në vendin tjetër, dhe synojnë të shkojnë në ato vende ku lehtësirat janë të mëdha. Këtu mund t’ju tregoj 2-3 raste nomadësh digjitalë në Kroaci, por në kohën tonë të lirë. Në Kroaci është rasti i një amerikaneje, e martuar me një kroat, që u bë sebeb për t’u ngjizur ligji nomad digjital, i cili e bën vendin më tërheqës, që mund të vijë të jetojnë, sidomos zonat e ngrohta të Vlorës, për shembull, që janë bërë tani.

Neni 4.

Enslemvera Zake – Neni 4 “Objektivat e mbështetjes së *start up*-eve” riformulohet me këtë përmbajtje: “Mbështetja për zhvillimin e *start up*-ve ka për synim:

- a) Lehtësimin e krijimit, hyrjes në treg dhe ushtrimin e veprimtarisë së *startup*-eve;
- b) krijimin e një klime të favorshme për tërheqjen, përfshirjen dhe mbajtjen e talentit dhe burimeve njerëzore;
- c) lehtësimin dhe mbështetjen në aksesimin e burimeve financiare;
- ç) përfshirjen sociale dhe diversitetin në mbrojtjen e vlerave demokratike.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Eduard Shalsi – Kush është dakord me formulimin e komisionit? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtu?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne e miratuar nenin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kaluam miratimin, nuk mund të kthehem sërish mbrapsht.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo autokrat, por është procedurë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Para se të miratohet, po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me procedurë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jam i qartë.

Edhe unë kam humbur shumë herë.

Neni 5.

Enslemvera Zake – Në nenin 5 riformulohet shkronja “ç”: “Forma të tjera mbështetëse lehtësuese, të zhvilluara në bashkëpunim me palë të treta, sipas përcaktimeve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Eduard Shalsi – Kush është pro? Kundër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, faleminderit!

Kur ta zbardhin shërbimet e Kuvendit e përcaktojmë me vizë apo pa vizë.

Kush është pro me ndryshimet e propozuara? Kundër? Nuk ka. Abstenim?

Miratohet.

Neni 6.

Enslemvera Zake – Në nenin 6 dhe kudo në projektligj termi “Ministri i Shtetit për Mbrojtjen dhe Sipërmarrjen” zëvendësohet me termin “Ministri përgjegjës për Sipërmarrjen”, sepse më vonë kjo mund të bëhet ministri linje dhe të mos ketë nevojë për ndryshime të tjera ligjore.

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Zake!

Kush është pro me ndryshimet e propozuara? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 7.

Enslemvera Zake – Në nenin 7 të projektligjit bëhen ndryshimet si më poshtë:

Pjesa hyrëse numërtohet pika 1 dhe ndryshohet me këtë përmbajtje: “Ministri përgjegjës për Sipërmarrjen ka përgjegjësitë dhe kryerjen e detyrave të mëposhtme:

Në pikën 1 shkronja “c” riformulohet me këtë përmbajtje: “Kordinon me Ministrinë përgjegjëse për Financat dhe Ekonominë për planifikimin buxhetor të startup-eve, lehtësuesve dhe palëve të treta”.

Shkronja “c” riformulohet me këtë përmbajtje: “I propozon Këshillit të Ministrave miratimin e fondeve buxhetore për grante dhe forma të tjera të mbështetjes së startup-eve, lehtësuesve dhe palëve të treta, në përputhje me parashikimet e këtij ligji”.

Në shkronjën “d”, pas fjalës “lehtësuesve”, shtohet togfjalëshi “dhe palëve të treta”.

Shkronja “dh” riformulohet me këtë përmbajtje: “Miraton dhe publikon thirrjet për grante financiare ose masa mbështetëse, ku evidentohen format dhe sasia e granteve

financiare ose forma e masave mbështetëse që do të akordohet për mbështetjen e *start up*-eve, lehtësuesve dhe palëve të treta”.

Shkronjat “f” dhe “g” riformulohen me këtë përmbajtje:

“f”) “Administron faqen zyrtare në internet të institucionit, me qëllim informimin e ndërgjegjësimin të publikut, publikon thirrjet për grante dhe ofron shërbimet *start up – one-stop-shop* për mbështetjen e *start up*-eve dhe lehtësuesve”.

“g”) Asiston zhvillimin e ekosistemit, mbështetës për *start up*-et.

Shkronja “gj” hiqet si e panevojshme dhe ndryshon enumeracioni i shkronjave në vijim.

Në shkronjën “h” të projektligjit fjala “kërkesat” zëvendësohet me fjalën “aplikimet”. Pas fjalës “*start up*-et” shtohen fjalët “lehtësuesit dhe palët e treta” dhe pas fjalës “vlerësimi” shtohet “të tyre”.

Në shkronjën “i” të projektligjit, pas fjalës “*start up*-et” shtohen fjalët “lehtësuesit dhe palët e treta”.

Në shkronjën “j” të projektligjit pas fjalës “*start up*-et” shtohet fjalët “lehtësuesit dhe palët e treta” dhe fjalët “*start up*-et dhe inovacionin” zëvendësohen me fjalën “ekosistemi”.

Pas pikës 1 të numërtuar shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

“Në ushtrimin e detyrave të tij, sipas përcaktimeve të këtij ligji, ministri përgjegjës për Sipërmarrjen ndihmohet nga sekretari teknik i Këshillit Kombëtar, i cili e ushtron veprimtarinë bazuar në legjislacionin në fuqi për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Ekonomik Kombëtar”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Po.

Bujar Leskaj – Unë nuk kam njohuri të plota, por a mund të më sillni ndonjë ligj nga bota, ku ka detyrë ministri për të administruar faqen zyrtare në internet të institucionit? Problemi është të mos ulni nivelin e qeverisjes?! E kam sinqerisht, ndoshta ligji kroat apo ai slloven e ka te detyrat funksionale të ministrit që ai të administrojë faqen zyrtare në internet?

Eduard Shalsi – Ministria, të cilën edhe unë kam pasur mundësinë ta drejtoja, ka një numër shumë të kufizuar punonjësish, është ministër Shteti pa portofol. Kur thuhet “ministra” do të thotë ajo bashkë me stafin. Pra, nuk e ka një shërbim a) të *outsource*-r; b) të një enti tjetër, siç mund të ndodhë në shumë vende të botës. Kam parë përkufizime të tilla, që i linin përgjegjësi ministrisë dhe ministria i delegonte te departamentet përkatëse. Në rastin konkret përgjegjësia për faqen është e ministrisë. Edhe kur unë isha ministër, edhe tani...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, ministër pa portofol.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Po, të ministrit.

Më pas, se si ministri i delegon brenda institucionit, bëhet fjalë, mos harroni, për një ministri me një numër punonjësish shumë të kufizuar. Është ministri pa portofol.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Po.

Edona Bilali – Ministri i Shtetit, ndryshe nga ministri, sepse ne nuk jemi ministri, ne jemi ministër, dhe kur themi ministër nuk është, për shembull, Edona Bilali në këtë moment, por është ministër, baras Edona Bilali, plus dy këshilltarët, plus asistenti. 1 plus 4 është struktura. Kur themi “ministri” nënkupton 1 plus 4, që e administrojnë këtë ministri, sepse nuk kemi luksin, si ministritë e linjës, që ta administrojë drejtoria e IT-së, për shembull.

Eduard Shalsi – Dakord, është çështje teknike.

Kush është dakord me ndryshimet e propozuara nga komisioni në nenin 7? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 8.

Në nenin 8 nuk ka ndryshime. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 9.

Enslemvera Zake – Në nenin 9 të projektligjit bëhen këto ndryshime:

Në paragrafin e parë hyrës hiqen fjalët “kanë përgjegjësitë dhe”.

Në shkronjën “a” fjala “marrjen” zëvendësohet me fjalën “ofrimin”.

Në shkronjën “b” fjalët “idesë së biznesit” zëvendësohen me fjalën “aplikimit. Pas fjalës “start up-et” shtohen fjalët “lehtësuesit ose palët e treta”.

Në shkronjën “c” fjalët “në këtë ligj” zëvendësohen me fjalët “në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji”.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Po, e drejtë.

Kush është dakord me ndryshimet e propozuara? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 10.

Enslemvera Zake – Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Eduart Shalsi – Është procedurë.

Enslemvera Zake – Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:

Në pikën 1 në fillim të pikës para fjalës “personi”, shtohet fjala “individit”.

Në pikën 2 fjala “plotësimi të” hiqet.

Në pikën 3 fjala “regjistrimi” zëvendësohet me fjalën “vetëdeklarimi” dhe pas fjalëve “me ekosistemin” shtohen fjalët “mbështetës të tyre”.

Eduard Shalsi – A jeni dakord me propozimet e komisionit? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 11.

Enslemvera Zake – Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:

Në pikën 1 fjalët “krijohet dhe administrohet nga struktura përgjegjëse pranë ministrit të Shtetit për Mbrojtjen dhe Sipërmarrjen” zëvendësohen me fjalët “administrohet nga ministri përgjegjës për sipërmarrjen”.

Pikat 2 dhe 3 riformulohen me këtë përmbajtje:

2) “Regjistri shërben për vetëdeklarimin e *start up*-eve dhe lehtësuesve për mbajtjen e të dhënave të *start up*-eve dhe të lehtësuesve të vetëdeklaruar për kërkuesit dhe përfituesit e granteve dhe masave të tjera mbështetëse”.

3) “Në momentin e vetëdeklarimit të *start up*-it nga individit, personi fizik ose juridik, në regjistrin e *start up*-eve, automatikisht gjenerohet numri personal dhe dokumenti elektronik, pasaporta e *start up*-eve”.

Në pikën 4 fjalët “unik identifikimi” zëvendësohen me fjalën “personal”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – A jeni dakord me ndryshimet e propozuara në nenin 11? Kundër? Nuk ka. Abstenim?

Miratohet.

Neni 12.

Enslemvera Zake – Në nenin 12 bëhen këto ndryshime: pikat 1 dhe 2 riformulohen me këto përmbajtje:

1. “Me qëllim mbështetjen e zhvillimit dhe rritjes të *start up*-eve ofrohet shërbimi *start up one-stop-shop*, pranë ministrit përgjegjës për Sipërmarrjen.

2. Shërbimi startup *one-stop-shop* mund të ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera publike dhe në të përfshihen:

a) Dhënia e informacionit për kuadrin ligjor rregullator në fuqi, përfshirë, por pa u kufizuar në informacionin mbi detyrimet lidhur me marrëdhëniet e punës dhe sigurinë e

shëndetin në punë, si dhe për detyrimin për regjistrim në regjistrin tregtar, në përputhje me legjislacionin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe mbi detyrimet fiskale dhe/ose detyrime të tjera që do t'ju nënshtrohen individët e vetëdeklaruar si *start up* pas periudhës së inkubimit.

b) Dhënia e këshillimit lidhur me regjistrimin në regjistrin tregtar dhe mbrojtjen e të drejtave civile dhe tregtare, si dhe për regjistrimin dhe mbrojtjen e pronësisë intelektuale pas periudhës së inkubimit.

c) Organizimin e aktiviteteve informuese dhe njohëse ndërmjet startup-eve të interesuara.

ç) Dhënia e shërbimeve të tjera në drejtim të lehtësimit të aktivitetit tregtar të startup-eve, sipas përcaktimeve të miratuara me vendimi të Këshillit të Ministrave”.

Eduard Shalsi – A jeni dakord me ndryshimet e propozuara në nenin 12? Kundër? Nuk ka. Abstenim?

Miratohet.

Neni 13.

Enslemvera Zake – Në nenin 13 të projektligjit bëhen këto ndryshime:

Në pikën 1 fjalia e parë ndryshohet me këtë përmbajtje: “Ministri përgjegjës për Sipërmarrjen merr masa dhe angazhohet për të asistuar e bashkërenduar veprimtarinë e ekosistemit mbështetës për *start up*-et dhe asiston *start up*-et dhe lehtësuesit e përfshirë në ekosistem në bashkëpunim me këshillin.”

Pika 2 riformulohet me këtë përmbajtje: “Individi, personi fizik ose juridik, që ka fushë kryesore të veprimtarisë trajnimit ose dhënien e mbështetjes nëpërmjet formave të ndryshme në fushën e inovacionit dhe/ose teknologjisë ose në fusha të ngjashme me to, merr statusin e lehtësuesit të *start up*-eve, duke u vetëdeklaruar në regjistrin e *start up*-eve.”

Eduard Shalsi – A jeni dakord me ndryshimet e propozuara në nenin 13? Kundër? Nuk ka. Abstenim?

Miratohet.

Neni 14.

Enslemvera Zake – Neni 14 i projektligjit riformulohet me këtë përmbajtje: “Neni 14 Mbështetja e *start up*-eve dhe lehtësuesve të *start up*-eve nëpërmjet granteve dhe masave mbështetëse:

1. *Start up*-et dhe lehtësuesit e *start up*-eve të vetëdeklaruar në regjistër mund të përfitojnë mbështetje financiare me fonde buxhetore në formën e granteve, si dhe nga burime të tjera financimi, përfshirë, por pa u kufizuar në donacionet e huaja dhe/ose nga investimet e

lehtësuesve, sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi, nëse plotësojnë kriteret dhe rezultojnë fitues pas një procesi konkurrues e transparent përzgjedhjeje.

2. Ministri përgjegjës për sipërmarrjen shpall thirrjen për aplikime nga ana e *start up*-eve dhe lehtësuesve të e *start up*-eve, nëpërmjet publikimit në shërbimin *start up one stopshop*, në faqen zyrtare”.

3. Thirrja për aplikime...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Po, e keni për pikën 3?

Edona Bilali – Te pika 3, te shkronja “c” të shtohet “fuqizimi i të rinjve” dhe aty ku është “fuqizimi i grave sipërmarrëse” ta bëjmë “fuqizimi i vajzave dhe grave sipërmarrëse”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

“Rininë” është përpara.

Eduard Shalsi – Dakord.

Në lidhje me propozimin e zotit Leskaj, a jeni dakord?

Dakord.

Kurse për “fuqizimin e grave sipërmarrëse” termi “gra” është një term gjithëpërfshirës për gjininë, e kemi pasur edhe në ligje të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edona Bilali – Kemi një *email* nga “UN Women”, për këtë. E kemi reflektuar te ndryshimi i fundit që kemi sjellë...

Eduard Shalsi – Nuk ka problem. Zonja Denaj, ne e kemi diskutuar edhe herë të tjera dhe është thënë që nëse thoni termin “gratë” keni përfshirë dhe vajzat, apo jo?

(Zonja Denaj flet pa mikrofon)

Dakord. A jeni dakord me ndryshimet e propozuara në pikën e dytë? Dakord.

Vazhdojmë.

Enslemvera Zake – Pika 3. “Thirrja për aplikime për përfitimin e granteve dhe të masave mbështetëse përmban kërkesat dhe kriteret që duhet të plotësojnë *start up*-et dhe lehtësuesit e *start up*-ve, procedurat dhe afatet respektive, të cilat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, duke marrë parasysh prioritetet e përgjithshme, si më poshtë vijon:

a) Mbështetja e inovacionit në fusha prioritare për zhvillimin e vendit;

b) mbështetja e iniciativave që kanë impakt pozitiv mjedisor;

c) fuqizimi i të rinjve;

ç) fuqizimi i vajzave dhe grave sipërmarrëse

d) fuqizimi i përfshirjes sociale, diversiteti dhe impakti social;

dh) prioritete të tjera, sipas urdhrimit të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.

4. Me qëllim vlerësimit të kërkesave nga *start up*-et dhe lehtësuesit të *start up*-ve ngrihet Komisioni i vlerësimit, i cili kryesohet nga ministri përgjegjës për sipërmarrjen. Rregulla të hollësishme për përbërjen e Komisionit të vlerësimit, kriteret, procedura e përzgjedhjes dhe shpërblimit të anëtarëve të tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. *Start up*-et dhe lehtësuesit të *start up*-eve aplikues shpallen fituese me vendim të komisionit të vlerësimit vetëm nëse plotësojnë kriteret dhe përcaktimet e pikës 3, të këtij neni.

6. Vendimi i komisionit të vlerësimit për përfituesit e granteve financiare për mbështetjen e *startup*-eve, sipas thirrjes, botohet në faqen zyrtare të ministrit përgjegjës për sipërmarrjen.

7. Ministri përgjegjës për sipërmarrjen i propozon Këshillit të Ministrave vendimin për miratimin e dhënies së grantit nëpërmjet njësisë përgjegjëse. Vendimi i Këshillit të Ministrave zbatohet nga njësia përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi për buxhetin e shtetit.”

Eduard Shalsi – A jeni dakord me ndryshimet e propozuara me nenin 14? Kundër? Nuk ka. Abstenim?

Miratohet.

Neni 15

Enslemvera Zake – Në nenin 15 të projektligjit bëhen këto ndryshime:

Pika 1 riformulohet me këtë përmbajtje:

1. “Ministri përgjegjës për Sipërmarrjen gjatë periudhës së inkubimit dhe deri në përfundimin e zbatimit të projektit të mbështetur financiarisht si *start up* ose si lehtësues i *start up*-eve, monitoron periodikisht *start up*-et dhe lehtësuesit të *start up*-ve, që kanë fituar masë mbështetëse nëpërmjet granteve, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së zbatimit të këtij ligji.”

2. Në pikën 2, fjalët “dhe struktura përgjegjëse e tij” hiqen. - Në pikën 3, fjalët “në urdhrin përkatës të” bëhen “me urdhër të”.

3. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje: “Në rast të abuzimit të masave mbështetëse nga *start up*-et, lehtësuesit ose palët e treta, ministri përgjegjës për sipërmarrjen mund t’i propozojë Këshillit të Ministrave kthimin e shumës së përfituar sipas këtij ligji.”

Eduard Shalsi – A jeni dakord me ndryshimet e propozuara me nenin 15? Kundër? Nuk ka. Abstenim?

Miratohet.

Neni 16.

Enslemvera Zake – Neni 16, saktësohet duke u riformuluar si më poshtë aktet nënligjore:

1. “Ngarkohen Këshilli i Ministrave që brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve: 5; 8 pika 4; 9 shkronjat “a”; 11 pika 5; 12 pika 3; 13 pikat 1 dhe 3 dhe 14, pikat 3 dhe 7 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për sipërmarrjen, që brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor, në zbatim, të nenit 15 pika 3, të këtij ligji.”

Eduard Shalsi – A jeni dakord me ndryshimet e propozuara në nenin 16? Kundër? Nuk ka. Abstenim?

Miratohet.

Neni 17.

Propozimi i parë i zotit Leskaj u mor në konsideratë, propozimi i dytë u bë pak me vonesë, propozimin e tretë për afatet e ligjit 6 muaj apo 3 muaj, në fakt, është “deri në 6 muaj”, ministrja është e interesuar t’i bëjë brenda 2 javëve, por është “deri në 6 muaj” nuk thuhet pas 6 muajsh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, këtë e kemi si objekt diskutimi një herë tjetër.

A jeni dakord me nenin 17? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Duke ju falënderuar mbyllim mbledhjen për sot.

Shihemi të enjten në seancë plenare.

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretare e komisionit

Enslemvera Zake

Përgjegjësja e Shërbimit të Redaktorëve

Euzheni Pengili

Sekretar Administrariv

Elvi Prifti